

## Dritëshkronja

Dritëshkronja, kjo fjalë e bukur shqipe u përdor për herë të parë në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Me kalimin e kohës ajo u zëvendësua me fjalën ndërkombëtare fotografia. Këtu po e ringjallim një herë për të krijuar një lidhje midis fotografisë së hershme dhe Shqipërisë së shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe të fillimit të shekullit të njëzetë.

Fotografitë e Jozef Sekelit, të bëra gjatë ekspeditës austrohungareze në Shqipërinë e veriut, Kosovë dhe Maqedoni në vitin 1863, udhëtim ky i kryesuar nga albanologu Johan Georg fon Han, duket se janë fotografitë e para të këtij rajoni të Ballkanit. Ishte një ekspeditë për një ndër cepat me të panjohura të Evropës.

### Johan Georg fon Han

Shkencëtari gjerman Johan Georg fon Han (Johann Georg von Hahn, 1811-1869) konsiderohet si babai i albanologjisë. Ai ka lindur në Frankfurt am Main dhe studioi drejtësi në Gisen (Giessen) dhe në Hajdëlberg (Heidelberg). Nga viti 1834-1843 punoi për ministrinë e drejtësisë së Mbretërisë së re Greke. Nga 1843-1847 ishte konsull prusian në Athinë dhe pas kësaj periudhe u emërua zëvendëskonsull austriak në Janinë, ku ra në kontakt me shqiptarët dhe filloi të mësonte shqip. Në fund, më 1851, u emërua konsulli austriak në ishullin Siros.

Gjatë viteve të qëndrimit në Janinë, Hani bëri tre udhëtime në Shqipëri dhe mblodhi të dhëna për historinë, filologjinë dhe folklorin shqiptar. Ky material u botua në veprën e tij themelore në tre vëllime “Albanesische Studien” (Studime shqiptare), Jena 1854, e cila i hodhi themelet e albanologjisë. Shquhet gjithashtu për vëllimin “Griechische und albanesische Märchen” (Përralla greke dhe shqiptare), Lajpcig 1864, dhe për rrëfimet e ekspeditave të tij në Ballkan: “Reise von Belgrad nach Salonik” (Udhëtim nga Beogradi në Selanik), Vjenë 1861, dhe “Reise durch die Gebiete des Drin und Vardar” (Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit), Vjenë 1867, 1869.

Në ekspeditën e fundit nga gushti në nëntor 1863 Hani dhe bashkëudhëtarët e tij udhëtuan nga Durrësi dhe Shkodra nëpër lumin Drin për në Prizren në Kosovë, në Maqedoninë perëndimore. Pastaj duke kaluar luginën e Vardarit erdhën në Selanik në detin Egje. Interesat e Hanit në Shqipëri dhe në Ballkanin jugperëndimor ishin të shumëllojshme dhe, gjatë këtij udhëtimi, përveç albanologjisë, i hodhi, mbase paditur, edhe themelet e historisë së fotografisë në Ballkanin jugperëndimor. Ekspedita e vitit 1863 rezultoi në një koleksion prej pesëdhjetë fotografish – nga më të hershmet në rajon.

Hani kishte filluar ta përgatiste ekspeditën në lumin e Drinit në fillim të viteve 1860, kur tha: “...është më pak i njohur se të gjithë lumenjtë e Evropës megjithëse derdhet në Adriatik jo më shumë se dhjetë milje nga kufiri jugor i territorit perandorak (të Austro-Hungarisë). Askush para meje nuk ka kryer udhëtimin njëzetditësh midis bregdetit dhe pikës ku bashkohet degat e lumit.” Kryeduka Maksimilian (1832-1867), i cili më vonë do të bëhej Perandori i Meksikës (mbreteroi 1864-1867), u entuziazmua me projektin dhe premtoi t’ia siguronte mjete të thjeshta të lundrimit për atë. Më 23 qershor 1863, Hani i dërgoi një letër Akademisë së Shkencave në Vjenë, duke kërkuar një fotograf kompetent i cili do ta shoqëronte dhe do të bënte fotografi të qyteteve dhe të terrenit malor. Akademia propozoi njëzetepesëvjeçarin Jozef Sekeli (Josef Székely) dhe dha në dispozicion fondet e duhura për ekspeditën.

### Jozef Sekeli

Fotografi vjenez, doktor Jozef Sekeli (1838-1901), ka lindur në Shymeg (Sümege) afër liqenit të Balatonit në Hungarinë perëndimore dhe ndoqi shkollën në Sombateli

(Szombathely). Më vonë studioi në Universitetin e Vjenës të cilin e mbaroi në vitin 1860 me një diplomë magister në farmakologji dhe në vitin 1862 me një doktoraturë në kimi. Ai dha mësim në universitet për një kohë të caktuar dhe pastaj hapi një studio fotografike në Heinrichshof përballë ndërtesës së operës në Vjenë. U bë fotograf profesionist me famë. Në vitin 1867 ai fitoi çmimin e bronxtë në Panairin Botërore në Paris (ndoshta me fotografitë e Shqipërisë) dhe më 1878 fitoi në Paris çmimin e argjendtë.

## **Ekspedita**

Johan fon Han u nis nga konsullata e tij në ishullin Siros dhe mbërriti në Durrës më 12 gusht 1863. Aty shënoi: “Qyteti s’ka ndryshuar që prej vizitës sime të fundit para trembëdhjetë viteve, as pesëdhjetë banorë më shumë nuk ka.” Ai ngjiti luginën e Erzenit, duke kaluar Ndroqin, dhe vazhdoi nëpër fushën bregdetare për në Shkodër. Aty më 31 gusht 1863, e gjeti Sekelin dhe togerin e marinës Herman fon Shpaun (Hermann von Spaun, 1833-1919) të cilët kishin arritur nga Tivari. Gjithashtu në grup ishin miku i vjetër i Hanit, Doktor Auerbah (Auerbach), i cili prej vitit 1845 kishte qenë mjek familiar i beut të Vlorës, si dhe prifti françeskan, Ëngjell Bardhi.

Në Shkodër, Sekeli bëri tetë fotografi të mahnitshme, pa dyshim fotografitë e para të qytetit dhe të kalasë së tij hijerëndë. Pas kësaj, ekspedita u nis në dy anije në lumin Drin, duke kaluar Dejën, Vjerdhën, Shurdhahun, Komanin (dy fotografi) dhe Dukagjinin. Lumi u bë gjithnjë e më i ngushtë dhe pranë Toplanës kalimi u bë i pamundur. Sekeli, i cili kishte sjellë pajisje të rënda fotografike me vete, u detyrua të kthehej në Shkodër me anije, kurse pjesa tjetër e ekspeditës vazhdoi rrugën me këmbë.

Grupi u ribashkua në Prizren i cili në atë kohë ishte qyteti më i madh i Shqipërisë. Prizreni kishte rreth 46.000 banorë, prej të cilëve 36.000 myslimanë, 8.000 bullgarë dhe vllah, dhe 2.000 katolikë. Kishte jo më pak se njëzetegjashtë xhami, si dhe dy kisha orthodoxe dhe një kishë katolike. Në krahasim me të, Shkodra, Durrësi dhe Vlora ishin fshatra. Këtu, në fillim shtatori 1863, Sekeli bëri pesë fotografi. Pas Prizrenit, ekspedita u kthye në Drinin e Zi dhe vazhdoi në drejtim të jugut për në Dibër. Kjo krahinë ishte krejtësisht e panjohur dhe gëzonte një nam të dyshimtë. Hani shkroi: “Po kaq e panjohur se pjesa e poshtme e lumit Drin ishte edhe lugina e Drinit të Zi midis qytetit të Dibrës dhe pikës ku bashkohen të dy degët e lumit. Thuhet se është një çerdhe hajdutësh dhe prandaj shmanget nga fqinjët.” Megjithatë, Hani kaloi rajonin pa probleme, veç që nuk mundi të kuptonte shqipen e banorëve aty. Kur erdhën në Dibër më 21 shtator 1863, Sekeli bëri dy fotografi. Fotografimi ishte një punë e lodhshme. Për të përdorur “makina fotografike” dhe vagonin e pllakave që kishte sjellë me vete, Sekelit i nevojitej dy orë e gjysëm thjesht për një fotografi të një shkëmbi të madh romantik. Gjithë kjo i tregoi Hanit se “fotografia s’është gjë që mund të kryhet shpejtshpejt. Ose mund të udhëtosh, ose mund të fotografosh.” Nga Dibra, ata vazhduan për në Strugë në liqenin e Ohrit.

Hani ishte i magjepsur nga liqeni dhe shënoi praninë e trembëdhjetë llojërave peshqish. Ata vizituan manastirin e Kalishtës, qytetin e Ohrit me shumë kisha të bukura orthodoxe, dhe natyrisht manastrin e njohur të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, Shën Naum, në jug të liqenit. Hani dhe bashkëudhëtarët e tij kaluan dhjetë ditë në Ohër keshtu që Sekeli kishte kohë për të fotografuar. Në Ohër dhe rajon u bënë gjithsej njëmbëdhjetë fotografi. Fotografia e Shën Naumit duket se është e vetmja foto e manastirit para se të digjej në masë të madhe në vitin 1875.

Prej Ohrit, grupi udhëtoi për në liqenin e Prespës dhe vazhdoi me shi të dendur për në Manastir. Tashmë ishte tetor. Manastiri ishte qytet i madh dhe selia kryesore e ushtrisë osmane për rajonin. Aty Hani u mirëprit prej Gjeneralit Faik Pasha, i cili kishte studiuar në Vjenë. Sekeli bëri disa fotografi të një formacioni ushtarak para kazermës së madhe, ndërtuar në vitin 1839. Nga Prilepi udhëtuan për në Veles mbi lumin Vardar ku, pasi gjetën anije të

reja, u nisën nëpërmjet ngushticës së Demir Kapit (Porta e Hekurtë) për në Selanik në detin Egje. Aty u bënë pesë fotografi. Prej Selanikut Hani dhe Sekeli vazhduan për në Turqi për të parë Trojën.

### **Koleksioni i Sekelit**

Johan Georg fon Han vlerësoi ndihmesën e madhe të Sekelit në ekspeditën e tij. Theksoi se fotografitë “mund të krahasohen lirisht me fotografitë më të mira të bëra ndonjëherë në këtë fushë.”

Për fat të keq, botimi i fotografive doli tepër i shtrenjtë për Akademinë vjeneze dhe ato nuk u përfshinë në raportin e Hanit, botuar në vitet 1876 dhe 1869. Rezultati i kësaj ishte që koleksioni i Sekelit, ndër fotografitë më të hershme të Ballkanit, u la në harresë. Në vitin 1889, trembëdhjetë foto të Sekelit u botuan në vëllimin “Makedonien und Alt-Serbien” (Maqedoni dhe Serbia e Vjetër) prej Spiridion Gopçeviqit (1855-1936), por pa datë dhe pa emrin e fotografit, mirëpo, pas kësaj, koleksioni u zhduk për më shumë se një shekull. U rizbulua në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë prej Mark Kohenit (Mark Cohen) në vitin 2000.

Fotografitë e Jozef Sekelit të bëra në jugun a gadishullit ballkanik në vitin 1863 kanë një rëndësi të madhe historike dhe artistike. Janë fotografitë më të hershme të Shqipërisë, me përjashtim të një portretit të vetëm të kryengritësit Hamzë Kazazi, të kryer prej fotografit shkodran Pjetër Marubi (Pietro Marubbi, 1834-1903) në Shkodër në vitin 1858. Mund të jenë edhe fotografi më të hershme të Kosovës dhe llogariten ndër fotot më të vjetra të Maqedonisë.

[Published in / Botuar në: *Albanica Ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë*, Prishtina, 72, September 2007, p. 10-14.]